



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 20/11/2020

Proces-verbal nr. 1

Bazuar në LIGJIN Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 16- 19 nëntor 2020 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të kryetarëve të fshatrave u zhvilluan takime të njëpasnjëshme me kryetarët e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Kletjon Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Thanas Tona Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në Njësitë Administrative. Mes tyre përmendi projektet : ndërtimi i ujësjellsave të rinjë në disa fshatra të Bashkisë Korçë, ndërhyrjet e njëpasnjëshme në rrugët e parcelave në të gjithë fshatrat e Bashkisë Korçë, ndriçimin publik, rehabilitimin e rrjetit të brendshëm rrugor në fshatrat e Bashkisë Korçë etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të kryetarëve të fshatrave për investimet gjatë vitit të ardhshëm në mënyrë që t’ju jepet prioritet atyre ndërhyrjeve që vetë ata i shohin më emergjente.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje”, dhe mundësinë që ata kanë për të zgjedhur vetë ato ndërhyrje që Bashkia e Korçës duhet t’i shohë me përparësi, kryepleqtë patën mundësinë për të parashtruar kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2021. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara sipas grafikut të takimeve të zhvilluara më poshtë.

Takimet e zhvilluara:

- 16 nëntor Njësia Administrative Bulgarec
- 17 nëntor Njësia Administrative Drenovë dhe Mollaj
- 18 nëntor Njësia Administrative Voskop, Voskopojë dhe Lekas
- 19 nëntor Njësia Administrative Vithkuq

Bazuar në kërkesat e ngritura nga kryetarët e fshatrave u listuan nevojat e tyre si më poshtë:

BULGAREC

- **Fshati Belorta:** Kanalizimet e ujrave të zeza, shtrimi i rrugëve të parcelave
- **Fshati Kuç i zi:** Mungesa e ujit të pijshëm, asfaltim i rrugës, rrethimi i varrezave të fshatit
- **Fshati Çiflig:** Fushë sporti, mungesa e ujit të pijshëm, asfaltimi i rrugës, kanalizimet
- **Fshati Neviçisht:** Asfaltimi i rrugës, sistemimi i varrezave, çakullim i rrugëve të fshatit, pastrim i kanaleve
- **Fshati Lumalas:** Depozitë për ujin e pijshëm, pastrimi i kanalit të vendtrokut dhe sistemim i ujrave të zeza

Në fshatin Belorta (Xxxxx Xxxx) Në fshatin Belorta kemi problem kanalizimet e ujrave të zeza pasi tek rruga e cila është e asfaltuar dalin në sipërfaqe dhe kalojnë para shkollës së fshatit. Gjithashtu edhe rrugët e parcelave kërkojmë të sistemohen për të na ndihmuar në punët e bujqësisë.

Në fshatin Kuç të zi (Xxxxx Xxxx) Mungesa e ujit të pijshëm në fshatin tonë do të ishte mirë të parashikohej për zgjidhje në Buxhet. Po ashtu edhe shtrimi i rrugës kryesore të fshatit pasi është e amortizuar. Varrezat publike kanë nevojë për një mur rrethues.

Në fshatin Çiflig (Xxxxx Xxxx) Fshati jonë nuk furnizohet plotësisht me ujë të pijshëm, prandaj ju lutem shikoheni me përparësi një gjë të tillë. Rruga e fshatit ka nevojë për një asfaltim në rrugët e çara nga ujësjellësi ndërsa ujrat e zeza derdhen në një kanal kullues të tokave bujqësore. Nëse do të bëhej edhe një fushë sporti do të ishte mirë për të rinjtë e fshatit.

Në fshatin Neviçisht (Xxxxx Xxxx) Kanali i përroit është i bllokuar dhe duhet të pastrohet pasi na ndihmon mjaft. Do ishte mirë të bënit një çakullim të rrugëve të brendshme të fshatit pasi janë prishur. Sistemimi i varrezave të fshatit pasi ka nevojë për disa ndërhyrje dhe asfaltimi i rrugës kryesore.

Në fshatin Lumalas(Xxxxx Xxxx) Për investimet që janë bërë në fshat ne jemi të kënaqur por kemi të domosdoshme një depozitë për ujin e pijshëm si dhe sistemimin e kanalizimeve të ujrave të zeza.

DRENOVË

- **Fshati Mborje:** rikonstruksioni i depos së ujit, rrethimi i varrezave, kanalizime për ujrë të shiut, shtimi i sipërfaqes së varrezave në Mborje, heqja e mbeturinave.
- **Fshati Ravonik:** rehabilitimii kanaleve të ujrave të zeza, pastrami i kanaleve kullues dhe vaditës, shtimi i kazanëve të plehrave, rikonstruksioni i rrugës në hyrje të fshatit.
- **Fshati Turan:** instalimi i rrjetit të ujit të pijshëm në varrezat e fshatit, pastrami i kanaleve të rrugës, rikonstruksion i qëndrës shëndetësore, rehabilitimii rrjetit të ujësjetllësit dhe kanalizimeve, rikonstruksionii rrjetit të brendshëm rrugor, ndërtimi i një qendre për moshën e tretë.
- **Fshati Boboshticë:** rehabilitimi i ujrave të zeza, shtim i ndriçuesve publik në fshat, shtimi i sasisë së ujit të pijshëm në fshat.
- **Fshati Dardhë:** ndërtimi i një zyre turistike, ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve, mirëmbajtje dimërore e rrugëve të fshatit, mirëmbajtja e varrezave dhe investim tek depoja e ujit.
- **Fshati Drenovë:** ndërtimi i një fushe futbollit, pastrami i plehrave, asfaltimi i rrugëve të brendshme të fshatit, sistemimi i hapsirave të gjelbërta.
- **Fshati Moravë:** kanalizimi i ujrave të zeza, rikonstruksion i rrjetit të ujit të pijshëm, ndriçim publik, kosha plehrash.
- **Fshati Qatrom:** shtrimi i rrjetit të ujësjetllësit dhe kanalizimet e ujrave të zeza, hapja e kanaleve vaditëse, asfaltimi i rrugëve të brendshme të fshatit dhe sistemimi i rrugëve të parcelave.

Në fshatin Mborje (Xxxxx Xxxxx) depoja e ujit ka nevojë për suvatim si dhe për rrethimin e pjesës së poshtëme, po ashtu për rrethim kanë nevojë edhe varrezat e reja, hapja e kanalizimeve për ujrë të shiut tek rruga e druve si dhe përgjatë rrugës së lumit, shtimi i sipërfaqeve të varrezave të fshatit me hapsirë të cilën më parë e kishte marrë ushtria, e domosdoshme është pastrimi i kazanëve të mbeturinave disa herë në javë.

Në fshatin Ravonik (Xxxxx Xxxxx) ndërtimi i kanalizimit të ujrave të zeza si dhe asfaltimi i rrugës që ka ngelur e pashtuar nga investimi i fundit, rikonstruksion i rrugës hyrëse të fshatit pasi është e amortizuar prej kohësh.

Në fshatin Turan (Xxxxx Xxxxx) kërkojmë të bëhet rehabilitimi i rrugëve dytësore të fshatit. E kemi të nevojshme ndërhyrjen në infermierinë e fshatit pasi është amortizuar nga vitet, si dhe një ambient për moshën e tretë pasi nuk kanë për momentin një ambient çlodhës.

Në fshatin Boboshticë (Xxxxx Xxxxx) Jemi të kënaqur dhe investime janë bërë por do të kërkojmë përmirësimin e ndriçimit publik me ndriçues të tjerë si dhe një zgjidhje alternative përse i përket furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemit të kanalizimeve.

Në fshatin Drenovë (Xxxxx Xxxxx) Për ato investime që janë bërë ne jemi shumë të kënaqur por duam një fushë futbollit, duhet ndërtuar dhe të jetë e përbashkët për Drenovën dhe Moravën, makinat e pastrimit të plehrave nuk hyjnë brenda zonave të banuara dhe për pasojë mbetjet grumbullohen për disa ditë atje, lulishtja tek busti i Asdrenit ka nevojë për ndërhyrje dhe sistemim si dhe asfaltimi i dy rrugëve të fshatit dhe ribërjen me kalldrëm të sheshit tek Lapidari.

Në fshatin Moravë (Xxxxx Xxxxx) për rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza vet banorët kanë bërë ndërhyrje por duhet edhe një ndërhyrje tjetër nga bashkia për sistemimin e tyre, kemi shqetësim me rrjetin e ujit të pijshëm pasi rrjeti ekzistues nuk është bërë sipas parametrave të duhur, gjithashtu vendosja e ndriçuesve publikë në fshat dhe vendosja e koshave metalikë.

Në fshatin Qatrom (Xxxx Xxxxx) 50-60 familje tek lagja e lumit janë pa kanalizime, rikonstrukcion i linjës së ujësjellësit të ujit të pijshëm pasi linja ekzistuese është e amortizur, Nëse është e mundur të bëhet shtim i sipërfaqeve të asfaltuara si dhe hedhjen e stabilizantit nëpër parcela për të lehtësuar punën në bujqësi.

Në fshatin Dardhë (Xxxxx Xxxxx) banorët e shohin shumë të domosdoshme hapjen e një zyre turistike në fshat për të orientuar turistët. E domosdoshme është gjithashtu mirëmbajtja dimërore e rrugëve të brendshme të fshatit. Depoja e ujit ka nevojë për sistemim, rrethim dhe ndriçim.

DVORAN

- **Fshati Ujëbardhë:** Ndërhyrje në depon e ujit, rrethim i varrezave, sistemim i rrugëve problematike, ndërhyrje në kanalën vaditës,
- **Fshati Mollaj:** Fushë futbollit, rrugët e parcelave
- **Fshati Floq:** Heqja e taksave për vaditje, sistemim i rrugëve, ujësjellësi për një lagje, sistemimi i kanalizimeve
- **Fshati Kamenicë:** Sistemimi i urës, shtrim i rrugëve të parcelave, kanalet kulluese, ndërhyrje në qendrën shëndetsore
- **Fshati Pulahë:** Sistemim i rrugëve të parcelave, ndërhyrje tek ura

Në fshatin Ujëbardhë (Xxxxx Xxxx) Në fshatin tonë ka nevojë për vënien në funksion të depos së ujit, pasi linja nuk është e përshtatëshme dhe nuk mban ngarkesën. Duhet të rregullohen varrezat e fshatit pasi muri ndarës është vendosur keq mes dy varreve. Gjithashtu kemi nevojë për një urë lidhëse në të dy anët e kanalit të Gjançit tek zona që njihet si arrat e hidrocentralit si dhe betonizim të kanalit vaditës.

Në fshatin Kamenicë (Xxxxx Xxxx) Në urën e fshatit duhet të vendosen parrakët pasi është e rrezikshme për fëmijët që kalojnë çdo ditë në të. Kemi të dëmtuara rrugët e parcelave dhe janë në gjendje të keqe që na pengojnë për të nxjerrë prodhimet bujqësore. Duhet disa tombino për urat me qëllim që të kalojnë ujërat malorë. Po ashtu edhe qendra shëndetsore ka nevojë për mur rrethues si dhe për ndërhyrje në çati pasi pikon.

Në fshatin Floq (Xxxxx Xxxx) Së pari ne kemi një shqetësim që familjet të cilat nuk mbjellin tokën të mos paguajnë taksë për vaditje pasi uji nuk shkon në çdo tokë. Tek lagja që u

dëmtua nga tërmeti, është në gjendje të keqe rruga e Kishës. Në lagjen e sipërme ujësjellësi është i domosdoshëm.

Në fshatin Pulahë (Xxxx Xxxx) Shtrimi i rrugëve të parcelave që lidhin tokat mes Pulahës dhe Dërsnikut pasi lehtësojnë punën e fermerëve. Plus kësaj duhet edhe një kanal vaditës në këto rrugë. Ura e cila ndodhet tek peshku siç e njohim ne, është urë kryesore dhe është hapur komplet duke u bërë e rrezikshme për të kaluar. Duhet të bëhet kjo urë dhe të vendoset tabelë kufizuese deri në pesë ton.

VOSKOP

- **Fshati Voskop:** uji i pijshëm, ujërat e zeza, asfaltim i rrugëve,
- **Fshati Polenë:** rrugët e brendëshme të fshatit si dhe rrugët e parcelave, pastrim i kanaleve të ujrave të zeza, sistemim i kanaleve vaditëse
- **Fshati Dërsnik:** sistemim i rrugëve, mungesa e mjekëve në ambulancë, ambiente çlodhëse, ndriçim publik
- **Fshati Damjanec:** sistemimi i rrugëve të parcelave, ndërhyrje në kabinën elektrike
- **Fshati Goskovë:** Sistemim i urës së fshatit, sistemim i unazës së fshatit, kanalizimet e ujrave të zeza, fushë sporti

Në fshatin Voskop (Xxxxx Xxxx) Është një burim uji në kodra me vetërrjedhje, nëse do të shtohet edhe ai do të ishte një zgjidhje e mirë për ujësjellësin e fshatit dhe nevojat për ujë. Duhet të sistemohen kanalizimet e ujrave të zeza dhe të asfaltohen disa prej rrugëve të brendëshme.

Në fshatin Polene (Xxxxx Xxxx) Jemi shumë të kënaqur me investimet që janë bërë në Polenë, por kemi dhe disa kërkesa të vogla do ishte mirë të shtrohen me stabilizant disa rrugë parcelash siç është ajo që ne e quajmë rruga e moçaleve. Kemi nevojë për pastrimin e kanaleve të ujrave të zeza.

Në fshati Dërsink (Xxxxx Xxxx) Kemi disa kërkesa siç është shtrimi i rrugëve të fshatit. Kemi problemin e mungesës së mjekut në qendrën shëndetsore e cila ka dhe nevojë për ndërhyrje. Do ishte mirë nëse do të bëhej edhe një lulishte para kësaj qendre shëndetsore. Rruga në lagjen Sopole e parregulluar si dhe ndriçim publik në lagjen poshtë.

Në fshatin Damjanec (Xxxxx Xxxx) Problem për ne është rruga që të çon në lagjen poshtë pasi nuk ka mur dhe duhet të shtrohet me bazë. Kemi problem kalimin në rrugët e parcelave pasi janë bërë të pakalueshme shkojmë punojmë me krahë se nuk futim dot mjetet, ndërsa çatia e kabinës elektrike është amortizuar dhe ka nevojë urgjente për ndërhyrje sepse paraqet rrezik.

Nëfshatin Goskovë Poshtë(Xxxxxx Xxxx) Aq investime sa janë bërë në fshat kanë qënë të mira. Problem për ne është vendosja e një mjeku në qendrën shëndetsore, kemi nevojë për një urë që lidh dy fshatrat e cila duhet bërë pasi është urë druri dhe e rrezikshme si pasojë e amortizimit. Një lagje e fshatit nuk ka ndriçim publik, si dhe nëse do të ishte e mundur një sistemim i unazës së fshatit pasi kemi problem me lëvizjen e makinave. Në kanalin e fshatit duhet të vendosen rreth 35 tombino për sistemimin e ujrave të zeza pasi janë shtatë rrugë.

VOSKOPOJË DHE LEKAS

- **Fshati Gjonmadh:** Sistemimi i ujsjellësit dhe kanalizimeve në fshat, përrrenjtë malorë sistemim, rrugët e brendëshme të fshatit, qëndra shëndetsore jashtë funksionit
- **Fshati Lavdar:** problem me infrastrukturën, fshati i ri pa qëndër shëndetësore, pjesa tjetër e rezervuarit duhet të mbarojë, çakullimi i rrugës së varreve, sistemimi i lulishtes të xhamia, probleme me kanalizimet.
- **Fshati Voskopoje:**Probleme me ujin e pijshëm, rrugët e parcelave, stallat e bagëtive
- **FshatiKrushovë:**rruga e brendëshme e fshatit, sistemim në varrezat e fshatit
- **Fshati Shipskë:** Vendosja e tombinove në rrugën e fshatit, zgjidhje e rrethimit të rrugës
- **Fshati Lekas:**Rregjistrimi i tokave me AMTP
- **Fshati Gurrëmuja:** Sistemim i urës së fshatit, Vënia në funksion e ujësjellësit të fshatit, sistemim rrugësh.

Në fshatin Gjonmadh (Xxxx Xxxx) Është e domosdoshme në fshatin tonë të ndërhyet për sistemimin e linjës së ujësjellësit dhe zgjidhjen e kanalizimeve. Disa nga përrrenjtë duhet të bëhen me beton, pasi gjatë periudhës së shirave përrrenjtë dalin dhe përmbysin banesat. Një tjetër kërkesë është ajo e sistemimit të rrugëve të fshatit dhe pajisja me tombino. Kemi qendrën shëndetsore e cila është e amortizuar dhe pa ujë e drita. Rruga e cila sapo u shtrua nga bashkia kërkon mbrojtëse anësore në dy vende

Në fshatin Lavdar (Xxxx Xxxx) Nevojë për ne mbetet rruga e fshatit e cila është e dëmtuar. Në fshatin e ri nuk ka një qëndër shëndetësore. Një pjesë e trotuarit është lënë përgjysëm dhe nuk ka mbaruar ende. Duhet të çakullohet rruga që të çon në varrezat e fshatit, duhet gjithashtu të sistemohet lulishtja tek xhamia e fshatit në mënyrë që të jetë një terren çlodhës. Në fshatin Lavdar i ri duhet të rregullohen kanalet kullues dhe të sistemohet pjesa e rezervuarit.

Në fshatin Voskopoje (Xxxx Xxxx) jemi shumë të kënaqur me punën që është bërë në fshat por duke qënë se jemi një fshat turistik është e mira që bagëtitë dhe stallat e bagëtive të dalin jashtë fshatit pasi është shqetësim për turistët. Kemi nevojë të rregullohen rrugët e parcelave.

Në fshatin Krushovë (Xxxx Xxxx) Në rrugën e fshatit makinat e kanë të pamundur të hyjnë brenda në fshat pasi kërkon një zgjerim. Rrethimi i varrezave të fshatit do të ishte mirë të bëhej.

Në fshatin Shipskë (Xxxx Xxxx) Ka nevojë për rrugë, kanalizime por edhe për disa investime të tjera. Është e domosdoshme që të zgjidhet rrethimi i rrugës së fshatit nga një banor.

Në fshatin Lekas (Xxxx Xxxx) Ajo që kërkojmë si fshat është përsheptimi i regjistrimit të tokave në hipotekë pasi është një problem që nuk po merr zgjidhje.

Në fshatin Gurrëmuja (Xxxx Xxxx): Kemi një urë në fshat tek hidrocentrali që ka nevojë për një kollonë betoni. Kemi probleme me ujësjellësin, ujë ka në burim por duhet tubo për të sistemuar linjën në mënyrë që të zgjidhet si problem. Nëse mund të ndërhyet në një pjesë të rrugës që lidh me fshatin Lekas do të ishte mirë.

VITHKUQ

- **Fshati Vithkuq:** probleme me lumin, pastrimi i rrugëve brenda lagjeve, restaurim i burimeve të ujit.
- **Fshati Rëhovë:** Riparim i pusetave të ujit të pijshëm, sistemim i përrenjve në fshat, sistemim i rrugëve të parcelave.
- **Fshati Lubonjë:** Përfundim i rrugës që lidh me Ersekën, pastrim i kanaleve kulluese, pastrimi i pemëve në rrjetin elektrik.
- **Fshati Panarit:** Mirëmbajtje e aksit gjatë periudhës dimërore, pastrimi i kanaleve kulluese, sistemim i rrugëve të parcelave.
- **Fshati Leshnje:** Betonizim i kanaleve vaditës riparim i linjës së ujit të pijshëm, pastrim i kanalit kullues.
- **Fshati Gjanç:** Tubacionet e ujrave të zeza, ujësjellësi në fshat, rruga për në Vithkuq

Në fshatin Vithkuq(Xxxx Xxxx) Kemi shqetësim lumin se në kohën që fillojnë rreshjet e shiut del nga shtrati. Kanalet e ujrave brenda fshatit duhet të pastrohen. Në lagjen Saraq deri në Makërz është rruga e dëmtuar, si dhe rrugët e brendëshme në të tria lagjet duhen rregulluar. Rruga që të çon në Shën Pandelimon dhe Shën Mëhill kanë nevojë për mirëmbajtje pasi janë zënë kanalet anësore. Po ashtu duhet rregulluar edhe rruga që të çon tek ura e madhe e fshatit, sepse është zënë në dy vende.

Në fshatin Rëhovë (Xxxx Xxxx) Puseta e ujit të pijshëm në fshat është ronitur dhe ka nevojë që të vendoset një e re. Rruga që të çon në Makërz është dëmtuar dhe ka nevojë për tre tombino për të çarë tre përrenj që kalojnë atje.

Në fshatin Lubonjë (Xxxx Xxxx) Nëse është e mundur të ndërhyet tek rruga e fushës që të lidh me Ersekën. Ka mbetur vetëm një pjesë e vogël dhe mund të zgjidhet lehtë. Nuk janë bërë kanalet kulluese të fushës, ka mbetur 350 hektarë tokë pa kanale. Gjithashtu nëse mundet të priten pemët afër linjave elektrike pasi herë pas here shkaktojnë probleme.

Në fshatin Panarit (Xxxx Xxxx) Është e domosdoshme që gjatë dimrit rruga të ketë mirëmbajtje dimërore sepse bllokohet. Duhet të bëhet pastrimi i kanaleve pasi kanalet janë funksionalë nga Mashkullora deri në Shtyllë, pjesa tjetër deri në Panarit nuk punojnë. Urat brenda fshatit duhet të ribëhen pasi janë ura druri që i merr lumi sepse janë dëmtuar. Rrugët e parcelave duhet të hapen me fadromë pasi nuk hyjmë dot në parcela bujqësore për të mbjellë tokat.

Në fshatin Leshnje (Xxxx Xxxx) Kemi nevojë për betonizimin e kanalit vaditës në lagjen mbi fshat. Uji i pijshëm në dy çezma ka nevojë për tubacione pasi janë disa shtëpi që nuk plotësohen në furnizimin me ujë. Në kanali kryesor kullues të fshatit Leshnjë prej kohësh nuk është ndërhyrë prandaj duhet sa më shpejt të pastrohet.

Në fshatin Gjanç (Xxxx Xxxx) Për ato investime që janë bërë ne ju themi faleminderit por ne kemi një kërkesë të vogël duhet 100 metro tubacion me tubo 200-she për kanalin e ujrave të zeza.